

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjykatësin Faton Bajrami, ne çështjenjuridike te paditësit Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli ne P., te cilën e përfaqëson K.E. me autorizim, kundër te paditurës O. Shpk me seli ne F., baza e kontestit: borxh, ne seancën e mbajtur me date 05.09.2018, ne prani te autorizuarit te paditësit, ndërsa ne mungesën e te paditurës te ftuar ne mënyrë te rregullte, ne kuptim te nenit 423.4 te LPK-se,me date 18.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET ne tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli ne P. dhe **detyrohet** e paditura “O.”Sh.p.k me seli ne F., qe ne emër te rimbursimit nga baza e sigurimit te garancionit te tenderit dhe ekzekutimit të kontratës paditëses te i paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 4,550.00 €, me kamate vjetore ne lartësi prej 8% duke filluar nga 14.02.2017 e deri ne pagesën definitive, te gjitha këto ne afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit nen kërcenim te përmbarimit me dhune.

DETYROHET e paditura qe paditësit te ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore ne shume prej 15,00 €, te gjitha këto ne afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit nen kërcenim te përmbarimit me dhune.

A r s y e t i m

Paditësja si ne padi ashtu edhe ne seancat e mbajtura përmes te autorizuarit te saj, ka kërkuar qe te aprovohet ne tërësi si e bazuar kërkesëpadia dhe te detyrohet e paditura qe ne emër te rimbursimit nga baza e sigurimit te garancionit te tenderit dhe sigurimit te kontratës,te i paguaj paditëses shumen e mjeteve ne lartësi prej 4,550.00 €,me kamate vjetore ne lartësi prej 8 %.

Paditësja ne padi dhe ne parashtrimet e bëra gjate shqyrtimit gjyqësor, ka theksuar se tani palët ndërgjyqëse, ne cilësi te kontraktuesve me date 24.06.2014, kane hyre ne raport kontraktual për sigurimin e garancionit te tenderit dhe ekzekutimit te kontratës. Ku me këtë kontrate (policen e sigurimit) tani paditësja ne cilësi te siguresit merrpër obligim qe te siguroi lenden e kontratës, obligimin kontraktor –tenderin e realizuar ne mes te këtu te siguruarit (kontraktuesit) dhe autoritetit kontraktues, deri ne shumen e siguruar.

Paditësja ne padi dhe ne shqyrtimin e mbajtur, ka sqaruar se tani këtu i padituri nuk ka përmbushur raportin kontraktual “Furnizimi me shoqëri bletësh dhe koshere” me autoritetin kontraktues – Komuna e P. dhe mbi këtë baze ka ndodhur konfiskimi i garancionit te lëshuar nga siguruesi, këtu paditësi, ne vlere prej 4,550.00 €(shuma e siguruar). Paditësja po ashtu ka theksuar se, me policen - kontratën e sigurimit, ka rezervuar te drejtën i rimbursimit te detyrimeve te kryera ne funksion te plotësimit te kërkesës ndaj përfituesit, andaj mbi këtë baze ka te drejtën e rimbursimit te shumes se siguruar e cila është konfiskuar nga autoriteti kontraktues ne lartësi prej 4,550.00 €.

I padituri përkundër faktit se ka pranuar aktvendimin – për përgjigje ne padi me date 16.01.2018 si dhe ftesën për seancën e datës 18.09.2018, e qe vërtetohet nga nënshkrimi ne fletëkthesën e datës 19.07.2018, ne seance nuk ka prezantuar, mungesën nuk e ka arsyetuar, e po ashtu nuk ka parashtruar as kundërshtime ne forme te shkruar.

Me e qellim te vërtetimit te gjendjes faktike gjykata beri administrimin e provave me leximin - shikimin e: polices se sigurimit te garancisë se tenderit dhe ekzekutimit te kontratës nr. ... te arritur me date 24.06.2014, parashtrësës te datës 15.09.2014- se kontraktuesit–përfituesit nga kontrata, pagesës–transferit date 27.05.2015, parashtrësës se datës 27.01.2016 te paditësit drejtuar te paditurit, me leximin e marrëveshjes jashtë gjyqësore date 11.03.2015.

Provat e administruara, gjykata i vlerësoi te gjitha një nga një dhe ne varësi me njëra tjetrën, ne vështrim te nenit 8 te Ligjit për procedurën kontestimore.

-nga polica e sigurimit te garancisë se tenderit dhe ekzekutimit te kontratës nr. 65241 te arritur me date 24.06.2014, gjykata konstaton sekëtu palët ndërgjyqëse, ne cilësi te kontraktuesve janë dakorduar qe përmes kësaj police te sigurimit, te sigurohet lënda e kontratës se tenderi, e arritur ne mes te këtu te paditurit ne cilësi te

kontraktuesit dhe Kuvendit Komunal ne P. ne cilësi te autoritetit kontraktues. Me këtë kontrate sigurimi, palët janë dakorduar qe këtu paditësi ne cilësi te siguresit te përmbush detyrimin, i cili nuk ekzekutohet për fajin e te siguarit- kontraktuesit (këtu te paditurit), po ashtu palët ne cilësi te kontraktuesve te sigurimit janë dakorduar qe te behet rimbursimi i shpenzimeve te kryera ne funksion te plotësimit te detyrimeve ndaj përfituesit.

-nga parashtresa e datës 15.09.2014, gjykata konstaton se autoriteti kontraktues Komuna e P. i eshte drejtuar me kerkese, këtu paditëses KS “K. e R.” me qellim te përmbushjes se detyrimit ka paraqitur kërkesë me shkrim për përmbushjen e detyrimit i cili nuk eshte realizuar me fajin e këtu te paditurës ne cilësi te kontraktuesit per shumen e mjeteve ne lartësi prej 4,550.00 €.

- nga pagesë - transferi i datës 27.05.2015, gjykata konstaton sepeditësi KS “K. e R.”, ne cilësi te siguresit ka përmbushur detyrimin, ndaj përfituesit te policës së sigurimit – Komuna e P., ne vend te te siguarit - këtu te paditurit.

- nga parashtresa e paditësit “K. e R.” e datës 27.01.2017, nen shenjen 296 drejtuar te paditurit, gjykata konstaton se paditësja KS “K. e R.” me ane te kësaj shkrese kërkon nga këtu i padituri “O.”shpk, me seli ne F.,qe te rimbursoi mjetet e paguara ne emër te sigurimit te garancionit, ne shumen prej 4,550.00 €, te cilat ia janë paguar përfituesit te polices Komuna e P..

-nga marrëveshja jashtë gjyqësore te datës 11.03.2015, gjykata konstaton se me meketë marrëveshje jashtë gjyqësore, tani këtu palët ndërgjyqëse janë dakorduar qe e paditura te rimbursoi ne tersi shumen e mjeteve te paguara nga paditësi për përfituesin e polices se sigurimit- autoriteti kontraktues- Komuna e P.. Ku me nënshkrimin e saj vete pala e paditur, e pohon detyrimin, mirëpo te njëjtin nuk e përmbush.

Gjykata pasi analizoi provat e administruara ne kuptim te nenit 8 te LPK-se dhe deponimit te palëve ndërgjyqësve, vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe atë ne baze te gjendjes faktike, gjykata vërtetoi se tani paditësja KS “K. e R.” me seli ne Prishtine, ne cilësi te siguresit, ka marre detyrimin për sigurimin e garancisë se tenderit dhe ekzekutimit te kontratës, te realizuar ne mes te këtu te paditurës O. ne cilësi te kontraktuesit dhe Komunës se P. ne cilësi te autoritetit kontraktues e ku nga provat e administruara rezulton se këtu e paditura ne cilësi te kontraktuesit nuk ka përmbushur detyrimin - raportin kontraktual “Furnizimi me shoqëri bletësh dhe

koshere” me autoritetin kontraktues – Komuna e P., mbi këtë baze paditësi ne cilësi te siguruesit ka përmbushur detyrimin, e pa ekzekutuar me fajin e te siguruarit, për shumën e mjeteve ne lartësi prej 4,550.00 €.

Andaj, mbi bazën e provave te administruara, gjykata aprovoi ne tersi kërkesëpadinë e palës paditëse duke qene se janë plotësuar ne tersi kushtet për subrogimin e kërkesës ne kuptim te nenit 281 të LMD-se, ku është përcaktuar se “kur detyrimin e përmbush personi, i cili ka ndonjë interes juridik ne këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, ne baze te vete ligjit, ne çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me te gjitha kërkesat aksesore”. E po ashtu edhe ne nenin 960 par.1 te LMD-se është përcaktuar se “me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë ne siguruesin, ne baze te vete ligjit deri ne shumën e kompensimit te paguar, te gjitha te drejtat e te siguruarit ndaj personit i cili mbi çfarëdo baze ështëpërgjegjës për demin.

Ndërsa lartësinë e kamatës, gjykata e ka aprovuar duke u bazuar ne nenin 382 te LMD-se, ne lartësi prej 8 %, siç ka kërkuar edhe vete pala paditëse ne padi, duke filluar nga data e ushtrimit te padisë..

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, sipas të cilit: “Pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare dhe ndërhyrësit të saj, të ja kompensoj shpenzimet gjyqësore”. Në rastin konkret shpenzimet gjyqësore si detyrim i të paditurës, përfshinë shumën prej 15.00 € dhe atë në emër të taksës për padi.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE, Departamenti Ekonomik

EK.nr.72/17 date 18.09.2018

G j y k a t e s i,

Faton Bajrami

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes Gjykatës se Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate.